



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK NR.1 TIRANË



Nr 1153 Prot

Data 3.10.2023

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune.

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
TIRANË

Në zbatim të ligjit nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, të ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, të udhëzimit nr. 14 datë 27.05.2021 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimatrinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”,

Ofruesi publik i AFP-së, Qendra e Formimit Profesional Publik Nr.1 Tiranë, ju njofton krijimin e **vendit të lirë për pozicionin/pozicionet:**

- Mësimdhënës, me kohë të pjesshme i kursit “Kuzhinë” (QFPP Nr.1 TIRANË) – 1 person

Kritere të përgjithshme

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar,
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën,
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale,
- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar,
- Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit,
- Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Kritere të posaçme

a) Të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në fushën/profesionin e kursit të formimit profesional, për të cilin po aplikon;

b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën është

kualifikuar;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara; Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 24.10.2023

DREJTOR

Hanëme MATA

